



**REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI KONTRAKTOR
SH.A UJESJELLESIBULQIZE**

Adresa : Lagjia Minatori Bulqize, Albania

email. ujesjellesibulqize@yahoo.com

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Nr _____ Prot

Bulqizë, më ____/09/2020

Për: **RES-03** me Adresë: Diber Bulqize BULQIZE Lagjia Minatori, qyteti Bulqize dhe NIPT: K26513468E

Procedura e prokurimit: “**Procedurë e Hapur**”.

Numri i referencës së procedurës/lotit: **REF-60175-06-05-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Shërbimi i ruajtjes dhe sigurisë fizike me roje private të depove të ujit.**” **Marrëveshje Kuadër kohëzgjatja 24 muaj**

Publikime të mëparshme **nuk ka**:

Buletini i Njoftimeve Publike Buletini Nr. 35 datë 15 Qeshor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **x**

oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. RES-03

Me NIPT: K26513468E

Vlera : 17 140 272,36 (shtatëmbëdhjetë milion e njeqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje tridhjetë e gjashtë. lekë PA TVSH

2. KEVENJO

Me NIPT: K36308746I

Vlera: 17 140 272,36 (shtatëmbëdhjetë milion e njeqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje tridhjetë e gjashtë. lekë PA TVSH

3. EUROGJICI-SECURITY

Me NIPT: K31929010K

Vlera: 17 140 271,76 (shtatëmbëdhjetë milion e njeqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një presje shtatëdhjetë e gjashtë lekë PA TVSH

4. NAZERI 2000

Me NIPT K31422029Q

Vlera: 17 140 272,36 (shtatëmbëdhjetë milion e njeqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje tridhjetë e gjashtë lekë PA TVSH

5. SAFE

Me NIPT: K41424040P

Vlera: 17 140 272,36 (shtatëmbëdhjetë milion e njeqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje tridhjetë e gjashtë lekë PA TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **KEVENJO**

Me NIPT: K36308746I

Vlera: 17 140 272,36 (shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje tridhjetë e gjashtë lekë PA TVSH)

2. **EUROGJICI-SECURITY**

Me NIPT: K31929010K

Vlera: 17 140 271,76 (shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një presje shtatëdhjetë e gjashtë lekë PA TVSH)

3. **NAZERI 2000**

Me NIPT K31422029Q

Vlera: 17 140 272,36 (shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje tridhjetë e gjashtë lekë PA TVSH)

4. **SAFE**

Me NIPT: K41424040P

Vlera: 17 140 272,36 (shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje tridhjetë e gjashtë lekë PA TVSH)

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

- SAFE: me vlerë te ofertuar: 17 140 272,36 (shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje tridhjetë e gjashtë

1. Në kriteret e veçanta në kapacitetin teknik pika 2 është kërkuar:

Licencë për ushtrimin e aktivitetit lëshuar nga QKL sipas ligjit nr.10081, date 23.02.2009 në fushën e veprimtarisë së shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike, kategoria e licences I.3.A

Licenca e shoqërisë e paraqitur në dokumentat e tenderit është e pa rinovuar sepse vendimi i drejtorisë së përgjithshme të policisë së shtetit është i dates 31/12/2015

Ndërsa çerifikata e drejtuesit ligjor është rinovuar me datën 25/02/2020 Nr.171/6.prot. pas kësaj duhej bërë edhe rinovimi i QKB.

2. Në pikën 5 Çertifikata për punonjës shërbimi **13** (trembëdhjetë) të lëshuara nga DVPQ – Dibër.

Çertifikata për punonjës shërbimi **13** (trembëdhjetë) të lëshuara nga DVPQ –Dibër

OE Safe sipas listës emërore të paraqitur nga DVP Dibër ka në listë 12 punonjës shërbimi.

Për punonjësin e shërbimit Hasan Kola nuk ka paraqitur çertifikatë shërbimi, pra nuk përmbush kriterin e mësipërm nga çertifikata shërbimi OE ka 11.

3. Në pikën 7 të kapacitetit teknik ku është kërkuar konkretisht Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Dibër** (45 ditë nga data e hapjes ofertave) ku jepet informacioni i mësipërm i kërkuar. *Në këtë vërtetim, subjekti SHPSF nuk duhet të ketë asnjë masë administrative për OE, Titullarin dhe Drejtuesin Teknik (të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për SHPSF-të) të dhënë nga Policia e Shtetit nga data 1 (një) janar e vitit 2019 e në vazhdim*

Në vërtetimin e paraqitur nga OE i lëshuar nga DVP Dibër me NR 160/1 prot datë 02/06/2020/rezulton se OE SAFE ka masë administrative për vitin 2019.

Në pikën 9 të kapaciteti teknik është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria Inspektoriatit të Punës të Qarkut Dibër se nuk ka Gjoha dhe vërejtje për sa I

përket aktivitetit në Qarkun Dibër të Subjektit nga 01.01.2018 e në vazhdim deri në zhvillimin proçedurës së prokurimit.

Në vërtetimin e paraqitur nga OE Safe datë 10/07/2020 i cili është pa Nr.prot, si rrjedhojë nuk plotëson elementet formal të dokumentit të lëshuar nga një institucion shtetëror. Ky vërtetim shprehet vetëm për vitin 2019-2020 dhe jo për periudhën 2018 deri në zhvillimin e proçedurës sipas percaktimeve në dst.

OE nuk përmbush kriterin e mësipërm.

Në pikën 11 të kapacitetit teknik . Subjekti SHPSF duhet të paraqesë Akt Miratimi për Qendër Kontrolli në Qarkun Dibër të përshtatshme për të kryer shërbimin e ruajtjes së sigurisë fizike. Shoqëruar me Çertifikatën e pronësisë ose kontratën e qirasë e cila të jetë e vlefshme të paktën deri në datën e zhvillimit të proçedurës .

OE SAFE ka paraqitur kontratë qeraje të datës 13/02/2015 me NR. Rep.1126 dhe kol.259 kontrata shprehet se afati për qeranë fillon me 15/04/2014 e në vazhdim kontrata nuk ka të shprehur Nr e pasurisë, zonën kadasrale si dhe nuk ka paraqitur certifikatën e pronësisë të kërkuar në dst si dhe nuk janë ID e kontraktorëve.

Kriteri i mesipërm nuk përmbushet nga OE

Në pikën 13 Vërtetim lëshuar nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguar për periudhën Janar 2020 deri në zhvillimin e proçedurës, shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore, ku operatori ekonomik duhet të ketë të siguar, jo **më pak se 13 punonjës shërbimi**, në Qarkun Dibër përjashtuar Titullarin e Subjektit dhe Drejtuesin Teknik.

Nga verifikimet e në sistemin e ALBANIA rezulton se:

OE ekonomik Safe ka të siguar vetëm 3 punonjës shërbimi në periudhën e kërkuar nga të cilët Z.Hasan Kola nuk ka çertifikatë shërbimi. 7 punonjës të çertifikuar figurojnë të siguar deri në muajin Mars 2020, ndërsa për muajt e kërkuar në DST Prill-Maj nuk figurojnë të siguar.

1 punonjës nuk figuron në listapagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar janar/maj,

OE SAFE ka gjithsej 3 (tre) punonjës të siguar për periudhën janar Maj sipas kërkesë së AK në DST.

- NAZERI 2000 me vlerë të ofertuar 17 140 272,36 (shtatëmbëdhjetë milion e njeqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje tridhjetë e gjashtë.

1.Në kriteret e përgjithshme është përcaktuar se OE duhet të paraqesë deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme.

Nga verifikimi në sistemin e-Albania në vërtetimin me Nr.T02587705 datë 15/07/2020 (datën e hapjes së ofertave) gjeneruar nga sistemi rezulton se OE Nazeri 2000 se ka detyrime tatimore të papaguara.

Sa më sipër ky kriter nuk permbushet nga OE.(shtojca 7)

2.Në pikën 6 kapacitetin teknik kërkohet Autorizim Individual për operatorin ofertues lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për “Radiokomunikim” dhe “Radioalarm”, konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008, ku të përfshihet Bashkia Bulqizë,deri në 30 km.Në dokumentin e paraqitur nga OE Nazeri 2000 rezulton se në Autorizimin individual frekuencat e Radioalarmit në Bashkinë Bulqizë janë deri në 15 Km dhe jo 30 Km të kërkuar nga AK.

3.Në pikën 7 kapaciteti teknik është kërkuar Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Diber** për vitin 2020 (45 ditë nga data e hapjes ofertave) ku jepet informacioni i mësipërm i kërkuar.*Në këtë vërtetim, subjekti SHPSF nuk duhet të ketë asnjë masë administrative për OE, Titullarin dhe Drejtuesin Teknik (të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për SHPSF-të) të dhënë nga Policia e Shtetit nga data 1 (një) janar e vitit 2019 e në vazhdim.*

OE NAZERI 2000 ka paraqitur dokumentin për performancën e shoqërisë nga DVP Dibër NR 228 prot datë 14/07/2020 nga i cili rezulton se Operatori ekonomik nuk ka masë administrative për vitin në vazhdim, pra nuk shprehet për vitin 2019 sipas kerksës së AK.

4.Ne pikën Operatori ekonomik duhet të paraqesi vërtetim nga Drejtoria Inspektoriatit Punës të Qarkut.Dibër se nuk ka Gjoha dhe vërejtje përsa I përket aktivitetit në Qarkun Dibër të Subjektit nga 01.01.2018 e në vazhdim deri në zhvillimin e procedurës së prokurimit.Në vërtetimin datë 14/07/2020 i cili nuk ka Nr protokolli pra nuk plotëson elementët formal të një dokumenti zyrtar shtetëror, vërtetimi nuk shprehet për vërejtje sipas kërkesës së AK.

Në pikën 10 të kapacitetit teknik AK ka vendosur kriterin e mëposhtëm:

5. Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë për **13** (trembëdhjetë) punonjës. Çertifikatat për ushtrim profesioni lëshuar nga DVP Dibër.(të vlefshme sipas Ligjit 75/14 datë 10.07.2014) .shoqëruar dhe me listën emërore.

Lista emërore ka 13 punonjës çertifikata të dorëzuara 10, punonjësit Z. Bajram Xhediku, Z. Artur Kallaverja, Z.Ervin PATA të cilët figurojnë në listën emerore të DVP Dibër më Nr,228prot datë 14/07/2020 OE nuk ka paraqitur çertifikata për ushtrim profesioni për këto punonjës. Ndërsa për punonjëit Z,Refik Elezi, Z, Fatjon Cakoni dhe Z.Lavdurim KOCI nuk figurojnë në listën emërore të DVP Dibër me Nr. 228 datë prot. 14/07/2020.Kriteri i mësipërm nuk plotësohet

Në pikën 13 Kapacitetit teknik Vërtetim lëshuar nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar 2020 deri në zhvillimin e procedurës, shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore, ku operatori ekonomik duhet të ketë të siguruar, jo **më pak se 13 punonjës shërbimi**, në Qarkun Dibër përjashtuar Titullarin e Subjektit dhe Drejtuesin Teknik.

Nga lista emërore e DVP Dibër Nr.228 datë 14/07/2020 ka 10 punonjës të siguruar. Dy punonjës Z. Bajram Xhediku dhe Z. Ervin Pata nuk kanë paraqitur çertifikatë punonjës shërbimi por janë të siguruar.

Artur Kallaverja i pasiguar dhe i paçertifikuar.

- EUROGJICI-SECURITY 17 140 271,76(shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e një presje shtatëdhjetë e gjashtë)lekë PA TVSH.

Në kriteret e përgjithshme është përcaktuar se OE duhet të paraqesë deklaratë për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme.

Nga verifikimi në sistemin e-Albania në vërtetimin me Nr. T02587749 datë 15/07/2020 (datën e hapjes së ofertave) gjeneruar nga sistemi rezulton se OE EUROGJICI-SECURITY ka detyrime tatimore të papaguara.

Sa më sipër ky kriter nuk përmbushet nga OE.(shtojca 7)

2.Në kapacitetin teknik janë kërkuar në DST Çertifikata për punonjës shërbimi 13 (trembëdhjetë) të lëshuara nga DVPQ –Dibër

Janë kërkuar 13 çertifikata punonjësish shërbimi, për punonjës Z.Osman Uka OE nuk ka paraqitur çertifikatë shërbimi dhe nuk figuron i siguruar në listëpagesat e shoqërisë,po ashtu Z. Defrim Plaku nuk figuron në listpagesën e shoqërisë.

Per sa më sipër ky kriter nuk përmbushet.

3.Në pikën 7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Diber për vitin 2020 (45 ditë nga data e hapjes së ofertave) ku jepet informacioni i mësipërm i kërkuar.Në këtë vërtetim, subjekti SHPSF nuk duhet të ketë asnjë masë administrative për OE, Titullarin dhe Drejtuesin Teknik (të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për SHPSF-të) të dhënë nga Policia e Shtetit nga data 1 (një) janar e vitit 2019 e në vazhdim, Vërtetimi shprehet vetëm për vitin e aktivitetit në vazhdim dhe jo për periudhën 1 janar 2019 e në vazhdim

Për masat administrative shprehet për drejtuesin teknik dhe administratorin, ndërsa për subjektin nuk shprehet nëse ka masa administrative apo nuk ka. Në vërtetimin e paraqitur nga DVP Dibër formulimi për masat administrative është i paqartë sepse nuk shprehet nëse ka apo nuk ka masa administrative, Vërtetimi shprehet se gjatë vitit në vazhdim kontrole të ushtruara 3Masa administrative GJITHSEJ.

4.Në pikën 9 në kapacitetin teknik është kërkuar që Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria Inspektoriatit Punës të Qarkut Dibër se nuk ka Gjoha dhe vërejtje për këtë aktivitetin në Qarkun Dibër të Subjektit nga 01.01.2018 e në vazhdim deri në zhvillimin e procedurës së prokurimit.Vërtetimi i paraqitur nga OE ekonomik nuk plotëson elementet formalë të dokumentit zyrtar shtetëror, pasi ky vërtetim është paraqitur pa Nr.protokolli. në këtë vërtetim rezulton që në periudhën e kërkuar në DST subjekti rezulton se në dy raste ka shkelje të lehta dhe në një rast është gjobitur në datën 18/03/2019.

5.Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga të gjitha njesitë administrative. të regjistruar në QKB ,si dhe në njesinë administrative ku ka selinë qendrore të regjistruar në QKB për shlyerjen e detyrimeve të taksave vendore për vitin 2019.Nga verifikimi i ektstaktit

historik të OE rezulton që ka hapur adresë në Bashkinë Shkodër në datën 20.11.2019 dhe nuk ka paraqitur vërtetim nga Bashkia Shkodër për vitin 2019.

Sa më sipër ky kriter nuk plotësohet.

6 Në pikën 13 Vërtetim lëshuar nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguruar për periudhën Janar 2020 deri në zhvillimin e procedurës, shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore, ku operatori ekonomik duhet të ketë të siguruar, jo **më pak se 13 punonjës shërbimi**, në Qarkun Dibër përjashtuar Titullarin e Subjektit dhe Drejtuesin Teknik.

Në listën emërore të lëshuar nga DVP Dibër ka 14 punonjës shërbimi nga këto: për punonjës Osman UKA nuk është paraqitur certifikatë shërbimi si dhe nuk figuron në listëpagesat e kësaj shoqërie për periudhën e kërkuar. Punonjësi Z. Defrim Plaku nuk figuron në listëpagesat e shoqërisë. Numri i punonjësve të siguruar nga OE është 12 dhe jo 13 të kërkuar nga AK.

Kriteri i mësipërm nuk përmbushet.

Nuk plotëson pikën 16. Oferta juaj refuzohet pasi vlera e paraqitur nga ana juaj është nën koston e lejuar ligjore për arsye se nuk është llogaritur sipas shtojcës 1 (sçarime).

- KEVENJO. Me vlerë të ofertuar 17 140 272,36 (shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje tridhjetë e gjashtë) lekë PATVSH

Në kapacitetin ekonomik 3.2 AK ka kërkuar, Operatorët Ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesin bilancet e tre viteve të fundit (2016, 2017, 2018) të certifikuara nga Administrata Tatimore. Për të tre vitet ketë aktivitet pozitiv. Nga verifikimi i bilanceve rezulton se Bilanci i vitit 2016 është me humbje (negativ)

Për sa më sipër nuk plotëson këtë kriter

Në pikën 1 të Kapaciteti teknik 3.3

Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më të vogël se 40% e fondit limit e shprehur në vlerë **6920000** (gjashtë milion e nëntëqind e njëzet mijë) lekë, nga data e zhvillimit të tenderit. Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohen kontrata, vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar **me sektorin privat** si dëshmi pranohen vetëm kontrata dhe faturat tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Pas verifikimit të dokumentacionit rezultoi se OE KEVENJO nuk ka paraqitur kontratë për shërbime të ngjashme.

Kriteri i mësipërm nuk plotësohet.

Në pikën 7 Kapaciteti teknik AK ka kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të paraqesë **vërtetim nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Diber** për vitin 2020 (45 ditë nga data e hapjes ofertave) ku jepet informacioni i mësipërm i kërkuar. *Në këtë vërtetim, subjekti SHPSF nuk duhet të ketë asnjë masë administrative për OE, Titullarin dhe Drejtuesin Teknik (të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi për SHPSF-të) të dhënë nga Policia e Shtetit nga data 1 (një) janar e vitit 2019 e në vazhdim,*

Në vërtetimi e paraqitur nga OE KEVENJO i cili mban datën 25.06.2020 Nr. 196 prot. Të lëshuar nga DVP Qarku Diber rezulton se vërtetimi nuk është konform kërkesës së bërë nga AK shprehet vetëm për ushtrimin e aktivitetit të vitit në vazhdim (2020) dhe jo për periudhën 01.01.2019 të kërkuar ne DST.

2.Në pikën 7 Kapaciteti teknik AK ka kërkuar që Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim lëshuar nga të gjitha njësitë administrative të regjistruar në QKB, si dhe në njësinë administrative ku ka seline qëndrore të regjistruar në QKB për shlyerjen e detyrimeve të taksave vendore për vitin 2019

Nga verifikimi i ekstrakti historik të OE KEVENJO rezulton se më datë 14.06.2019 ka shtuar adresë në Bashkinë Tiranë me adresë:Tiranë; TIRANE; Tiranë; ; TIRANE; Njësia Bashkiake Nr.9, Rruga Don Bosko, Pallati Nr.36, Kati i parë, Dyqani Nr.10;.

OE nuk ka paraqitur vërtetim për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 Bashkia Tiranë.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim nga Drejtoria Inspektoriatit Punës të Qarku Diber se nuk ka Gjoha dhe vërejtje përsa i përket aktivitetit në Qarkun Diber të Subjektit nga 01.01.2018 e në vazhdim deri në zhvillimin e procedurës së prokurimit.

Në vërtetimin e lëshuar nga Drejtoria Inspektoriatit Punës të Qarkut Diber datë 20.06.2020 Nr.80,prot.rezulton se, vërtetimi i mësipërm shprehet për masa administrative (gjobë) por nuk shprehet për vërejtje siç është kërkuar në DST.

Në pikën 13. AK ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të paraqesë,Vërtetim lëshuar nga administrata tatimore për numrin e punonjësve të siguar për periudhën Janar 2020 deri ne zhvillimin e procedures, shoqëruar me listëpagesat e sigurimeve shoqërore, ku operatori ekonomik duhet të ketë të siguar, jo **më pak se 13 punonjes sherbimi**, ne Qarkun Diber përjashtuar Titullarin e Subjektit dhe Drejtuesin Teknik.

Nga verifikimet e punonjësve sipas listës emërore e DVP Qarku Diber i datës 25.06.2020 me Nr.196.ku janë shënuar të dhënat e punonjësve të shërbimit rezultoi se 12 punonjës shërbimi nga 17 punonjës që ka lista emërore e leshuar nga DVP Qarku Diber dhe çerifikatat e lëshuara sipas kësaj liste figurojnë të siguar nga Janar 2020-maj 2020 sipas listëpagesave të paraqitura nga OE, nga verifikimet në sistem këto 12 punonjës figurojnë të siguar nga mars 2020 e në vazhdim.

Ndërsa 5 punonjës nuk janë të siguar për periudhën e kërkuar, Z.Ahmet sefullaj nuk figuron në listpagesë, Z.Ali Domazeti nuk figuron në listpagesë, Z.Fari XHARI është i siguar tek OE KEVENJO deri në Muajin Mars 2020, pas kësaj periudhe figuron i siguar në shoqërinë IG,Sha.Z.Ervis Liksala figuron i Siguar pranë Ujësjetllës kanalizime

Dibër.Z.Alket Shehu për periudhën Janar Shkurt Mars nuk figuron në lispagesë është i siguruar për periudhën Prill Maj Qeshor, aktualisht i punësuar tek IG Sha.Aktualisht punonjësit e shërbimit Z. Sefer Hoxha i punësuar tek IG SHA. Z.Përviz Trupja i punësuar pranë UKD DIBER.

Per sa më sipër kriteri nuk plotësohet.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **RES-03 me Adresë:** Diber Bulqize BULQIZE Lagjia Minatori,qyteti Bulqizeme NIPT: K26513468E se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 17 140 272,36(*shtatëmbëdhjetë milion e njëqind e dyzet mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy presje tridhjetë e gjashtë. lekë PA TVSH*) pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni në *Ujësjetllësin Bulqizë* për sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga data e këtij publikimi por në cdo rast subjekti është i detyruar t'i përgjigjet kërkesës së autoritetit kontraktor për lidhjen e kontratës brenda 5 (pesë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës në zbatim të nenit 21 të Vkm 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” I ndryshuar nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe procedura do të anulohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë :27/07/2020

Ankesa: Nr.362 prot, datë 03.08.2020

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë .10/08/2020 (vendim K.P.P Nr.375/2020)

Data e publikimit të këtij njoftimi: **17/09/2020**

**ADMINISTRATORI
ASLLAN DAXHA**